1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;

- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Gjatë hartimit të këtij projekti janë mbajtur në konsideratë detyrimet që lindin nga kuadri ligjor në fuqi në fushën e menaxhimit të pyjeve dhe në fushën e prokurimit publik.

Kuadri ligjor përkatës përbëhet nga:

- -Ligji Nr. 57/2020 datë 30.4 2020 “Për pyjet”;
- Ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, I ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 433, date 08.06.2016,i ndryshuar për “Transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/ Bashkive”;lidhja 43 i ndryshuar.
- Manualin e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 361, datë 12.05.2010, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullësor publik”;
- Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Mirditë Nr. 211,date 26.05.2025 Për “Ngritjen e grupit të punës, për përllogaritjen e fondit limit dhe termat e references “Per hartimin e planit të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe kullësore (ekonomia pyjore Kaçinar), Bashkia Mirditë”

Shenim: Per cdo paqartesi lidhur me termat e references, duhet ti referohen MANUALIT TË PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE të miratuar nga Ministria e

Specifikim (Manuali nr.864 Prot, datë 30.01.2019)

- **PLANI I Mbareshtimit** - Plani i Mbareshtimit të Pyjeve dhe Kullotave është një dokument baze për mbareshtimin e pyjeve i hartuar sipas njesive të ekonomisë pyjore me punime terreni e zyre, për njohjen dhe marrjen e të dhënave për token, klimen, faunen, biodiversitetin, grumbullin pyjor etj, si dhe masat që parashikohen për administrimin dhe qeverisjen e qëndrueshme të fondit pyjor, organizimin e prodhimit dhe planifikimin e punimeve të nderthurura të nevojshme silvikulturore.

Plani i mbareshtimit do të përfshijë pyjet (pyjet e lartë, cungishtet, shkurret) dhe kullotat që ndodhen në brendësi të kufijve të Bashkisë dhe për këtë arsye plani që do të hartohet do emërohet Plani i Mbareshtimit të Pyjeve dhe Kullotave (PMPK).

- **Bashkita (BA):** Janë pronarët legjitimë dhe administratorët e pyjeve dhe kullotave brenda territorit të tyre. Administrimi i pyjeve dhe kullotave kryhet nëpërmjet strukturave perkatese të shërbimit pyjor bashkiak dhe menaxhimi i tyre deri tanimë është kryer nëpërmjet planeve ekzistuese të mbareshtimit. Aktualisht, shumica e planeve të mbareshtimit të pyjeve në pronësi të bashkive kanë skaduar prandaj ka një nevojë urgjente për hartimin e udhëzuesit dhe fillimin e punës për hartimin e PMPK. Për këtë arsye BA është një aktor i rëndësishëm në procesin e hartimit të PMPK. Roli kryesor i Bashkisë në këtë proces do të jetë: - përcaktimi i kriterëve për përcaktimin e Ekonomisë pyjore/NJM - përcaktimi i nevojave për përgatitjen e planit të ri të pyjeve dhe kullotave bazuar në kriterin e urgjencës - alokimi ose aplikimi për fonde me qëllim përgatitjen e PMPK dhe drejtimi i procesit të hartimit të planit të mbareshtimit që nga nënshkrimi i kontratës deri në monitorimin final. - sigurimi i informacionit për Kadastrën Pyjore në lidhje me të dhënat e parcelave dhe nënparcelave (në të ardhmen e afërt tek SISP). - përcaktimi me bashkitë fqinje i nevojave për rregullimin e kufijve të ekonomive pyjore nëse është e nevojshme duke respektuar kufijtë sipas ndarjes së re administrative. - organizon dhe menaxhon procesin e pjesëmarrjes së aktoreve ose paleve të interesuara (pronarë, komunitet, përdorues pyjesh, shoqata të përdoruesve të pyjeve, OJQ). - transmeton të dhënat e monitorimit të përvitshëm të nderhyrjeve dhe ngjarjeve tek SISP dhe tek institucionet e tjera (AKM, MTM).

- **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) :** MTM është përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave të Kadastrës Pyjore, Planeve të Mbareshtimit të Pyjeve dhe SISP. Ajo menaxhon integrimin e informacionit të planeve aktuale që janë të vlefshme dhe të planeve të reja të mbareshtimit të pyjeve dhe kullotave të përgatitura për çdo Bashki në SISP. MTM bën miratimin final të PMPK, pasi bashkia ka bërë miratimin apo mbështetjen nga ana e saj.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Afati i ekzekutimit: 9 (nëntë) muaj

Për realizimin e hartimit të Planit të Mbarështimit për këtë ekonomi pyjore parashikohet një afat kohor **9 muaj sipas grafikut të ekzekutimit**. Kontraktori duhet të parashikojë dhe të detajojë në mënyrë të saktë të gjitha fazat e punës së domosdoshme deri në momentin final, atë të miratimit dhe dorëzimit të produktit përfundimtar. Fazat që ndiqen për hartimin e Planit të Mbarështimit dhe afatet përkatëse, pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm:

NR.	FAZAT E PLANIT TË MBARËSHTIMIT	MUAJT E VITIT											
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
1.	Nënshkrimi i fillimit të punës, vlerësimin e aftësive të stafit BA												
2.	Procesi i konsultimit me palët e interesuara dhe identifikimi qëllimeve dhe objektivave të PMPK												
3.	Puna përgatitore												
3.1.	Trajnimi i ekipit												
3.2.	Grumbullimi i dokumentave të nevojshme												
3.3.	Drafti i hartës pyjore (ndarja parcelare dhe rrjeti sipërfaqeve provë)												
4.	Puna e terrenit (të dhënat bazë)												
4.1.	Përgatitja e punës së terrenit												
4.2.	Përshkrimi parcellar												
4.3.	Inventarizimi i pyjeve dhe kullotave												
4.4.	Rekomandimet për												

	mbarështimin (objektivat dhe masat)												
5.	Raportimi i të dhënave dhe planifikimi aktiviteteve												
5.1.	Përgatitja e Raportit												
5.2.	Përgatitja e Hartës												
5.3.	Planifikimi vjetor ndërhyrjeve/aktiviteteve												
5.4.	Vlerësimi ekonomik												
6.	PMPK dhe SISP												
6.1.	Futja, trajnimi, grumbullimi të dhënave dhe hartave etj.												
6.2.	Përshkrimi parcellar (të dhëna nga SISP dhe sipërfaqet provë etj.)												
6.3.	Ngarkimi i raportit, planifikimi vjetor, hartat etj.												
6.4.	Procesi i validimit të PMPK në SISP												
6.5.	Miratimi PMPK												

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Termet e referencës me të gjithë elementët përbërës, hartohen duke u mbështetur në Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot, datë 30.01.2019.

Manuali përcakton në mënyrë të detajuar kërkesat që duhet të plotësojë subjekti i kontraktuar gjatë fazës së punimeve të terrenit dhe ato të përpunimit të dhënave në zyrë.

Këto terma reference do të shërbejnë për të përcaktuar përgjegjësitë, detyrat dhe kualifikimet e kërkuara për konsulentët që do të përgatisin Planet e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave për Bashkinë Mirditë, bazuar në Udhëzuesin e lartpërmendur.

FONDI LIMIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË MBARËSHIMIT

Bashkia Mirditë me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor për hartimin e planeve të reja të mbarështimit të fondit pyjor ka akorduar një fond limit, për hartimin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë.

Në përputhje me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik, nga ana e autoritetit kontraktor është realizuar përlllogaritja e fondit limit që do të përdoret për kontraktimin e subjektit/eve që do të hartojnë planet e reja të mbarështimit të ekonomive pyjore.

Fondi limit në total për hartimin e planit të mbarështimit për ekonominë pyjore Kaçinar është përlllogaritur në vlerën **12 616 500 lekë** pa TVSH dhe 15 139 800 lekë me TVSH.

Bazuar në Vendimin nr.361, datë 12.05.2010 “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullësor publik ” Shtojca 1 pika 2 “ Tarifat për veprimtarinë shërbime profesionale për projektme ” : shkronja a “ hartimi i planit 10-vjeçarë të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave publike për : Ekonominë pyjore “ Kaçinar ” me **sipërfaqe totale 5161 ha**, ku në baze të sipërfaqeve sipas kategorive të përdorimit të territorit, dhe te qeverisjes, vlerat janë si më poshtë:

Ekonomia Pyjore	Forma e qeverimit	Sipërfaqja (ha)	Çmimi për njësi lekë/ha	Vlera totale lekë
“EKONOMIA PYJORE KAÇINAR”	Pyje të larte(Trungishte klasa e I deri III e moshës)	2701		
	Pyje të ulët (Cungishte)	1088		
	Shkurre	204		
	Sipërfaqe me bimesi pyjore +djerr+ Inproduktive	1023		
	Kullotë + livadhe	145		
Totali i ekonomisë pyjore		5161		
TVSH 20 %				
T O T A L I				

KONTEKSTI

Bazuar ne urdherin e kryetarit nr.211, datë 26.05.2025 “ **Për përlogaritjen e fondit limit dhe termat e references “Per hartimin e planit të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe kullimore (ekonomika pyjore Kaçinar), Bashkia Mirditë”**, në ligjin 57 date 30.04.2020 “Per pyjet” Neni 13 pika 1.Të ardhurat nga aktivitetet në fondin pyjor kombëtar përdoren vetëm dhe në funksion të rimëkëmbjes së pyjeve, dhe pika 3. Të ardhurat e krijuara sipas përcaktimeve në shkronjën “ç” të pikës 2, përdoren 100% nga strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki, kryesisht për investime në fondin pyjor. Ne Vendimin nr.361, datë 12.05.2010 “ Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullor public ” Shtojca 1 pika 2 “ Tarifat per veprimatarinë shërbime profesionale për projektme ” : shkronja a “ hartimi i planit 10-vjeçare të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave publike për ekonomine pyjore “KAÇINAR”

Me reformen administrative dhe Ligjin Nr 115/2014, Republika e Shqipërisë ka krijuar njesite e reja administrative ose Bashkite ku nga bashkimi i njesive administrative të mëparshme prej 361 komunash dhe bashkish tashmë kemi vetëm 61 Bashki.

Me këta kufij te rinj kërkohet edhe përcaktimi i ekonomive pyjore dhe hartimi i planeve te reja te mbarështimit bazuar në këto parime:

- planet do perdoren per trungshtet, cungishtet, shkurret si dhe kullotat, dhe bimeve medicinale qe jane brenda kufijve te ekonomis pyjor Kaçinar, qe do te quhen Plan i Mbarështimit te Pyjeve/Kullotave dhe BMET.
- do te mbulojne te gjithë tipet e pronesise se pyjeve dhe kullotave
- periudha e vlefshmerise se planit eshte 10 vjet
- secili PMPK hartohet per 1 ekonomi pyjore. Baza per krijimin e njesive te reja te mbarështimit do te jene ekonomite ekzistuese pyjore, por sistemi i ri i mbarështimit eshte unik.
- PMPK te pergatitet duke perdorur mundesite aktuale te teknologjise ne termat e lidhjes se internetit dhe perdorimin e mjeteve informatike te reja sidomos ne lidhje me SISP qe menaxhon te dhenat e pyjeve dhe kullotave ne Shqiperi.
- PMPK bazohet ne klasifikimet e standartizuara qe jane te zakonshme per te gjithë planet dhe projektet e tjera si psh: IKP dhe keto do jene te pershtatshme edhe per SISP.

Menaxhimi i procesit per hartimin e PMPK eshte pergjegjesi e Bashkise.

OBJEKTIVAT

Detyra per hartimin e Planeve te reja te Mbarështimit te Pyjeve dhe Kullotave per nje ekonomi pyjore synon qe te arrije objektivat e meposhtme:

1. pergatitjen e nje plani shumefunksional duke mbuluar aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike.
2. njohja e burimeve lokale duke perfshire siperfaqet pyjore dhe jo pyjore, produktet drusore dhe jodrusore, kullotat dhe produktet e tyre, gjendja e turizimit dhe fasilitetet didaktike dhe te kerkimit shkencor.
3. njohja e problemeve lokale si: erozioni, rreshqitjet, zjarret ne pyje, prerja ilegale, mbikullotja etj.
4. pergatitja aktive dhe pjesmarrja ne te gjithë hapat e procesit te pjesmarrjes duke perfshire aktoret lokale ne hartimin dhe menaxhimin e PMPK.
5. menaxhimi i punes per hartimin e planit dhe futjen e tij ne SISP
6. përcaktimi i ndërhyrjeve per periudhen e vlefshmerise se planit te mbarështimit

7. mbeshtetja e Bashkise ne te gjitha fazat e hartimit te planit deri ne miratimin e tij nga MTM.

Ekonomia pyjore dhe kullosore per te cilen do te hartohet plani i mbareshtimit jepet ne tabelen e meposhtme:

Nr	Regjimi	Sip Ha
1	Pyje të larte(Trungishte klasa e I deri III e moshës)	2701
2	Pyje të ulët (Cungishte)	1088
3	Shkurre	204
4	Siperfaqe me bimesi pyjore +djerr+ Inproduktive	1023
5	Kullotë + livadhe	145
	Totali	5161

QELLIMI I SHERBIMIT

Hartimi i PMPK duhet të bëhet bazuar në parimin e mbareshtimit te qendrueshem qe nenkupton "te ruaje dhe te forcoje gjendjen shendetsore te ekosistemeve pyjore per nje afat kohe te gjate dhe ne te njejten kohe per te siguruar mundesi ekologjike, sociale, ekonomike dhe kulturore per mireqenien e brezave aktuale dhe atyre te ardhshem".

Ky plan hartohet per ekonomite pyjore qe jane pjese e Bashkisë Mirditë dhe natyrisht ne kordinim edhe me njesite e tjera ekonomike fqinje apo zonat e mbrojtura nese eshte e nevojshme.

Hartimi i planit te mbareshtimit eshte nje mjet per te njohur gjendjen aktuale te territorit, siguron nje ndeveprim me aktoret dhe bashkite si dhe kordinim me institucionet qendrore nepermjet perdorimit te SISP dhe kjo pritet te ndodhe gjate hartimit te PMPK dhe gjate drejtimimit te nderhyrjeve dhe ngjarjeve ne periudhen e vlefshmerise se planit. Perdorimi i nje metode te standartizuar te punes e percaktuar ne Udhezuesin e Planeve te Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave 2019, duhet te sherbeje per te siguruar rezultate homogjene dhe te krahasueshme ne nivel lokal duke perdorur proçedurat qe ofrohen nga SISP.

Sipas Udhezuesit, proçesi i hartimit te PMPK duhet te zhvillohet sipas ketyre hapave:

- Puna përgatitore (Mbledhja informacionit, trajnimi, prezantimi, sensibilizimi i komuniteteve lokale etj)
- Puna në terren (matja dhe mbledhja e të gjithë të dhënave të terrenit)
- Puna në zyrë (përpunimi, interpretimi, sistemimi, shkrimi etj)
- Miratimi

Puna e eksperteve te jashtem duhet gjithmone te zhvillohet ne bashkepunim te ngushte me Bashkine dhe stafin pyjor lokal si nje kusht themelor per te siguruar rezultate te mira. Me poshte jepet nje skeme e permbajtjes se proçesit, por hartimi i PMPK duhet absolutisht te zhvillohet sipas percaktimeve te Udhezuesit 2019.

PUNA PERGATITORE

- Grumbulli i te dhenave ekzistuese dhe dokumentave te nevojshme per hatimin e PMPK
- Futja ne SISP e planit te ri te mbareshtimit dhe menaxhimi i proçesit te punes
- Organizimi dhe menaxhimi i proçesit te pjesmarrjes se aktoreve

PUNA NE TERREN DHE PERSHKRIMI PARCELAR

- Vizitat ne terren
- Hartimi i hartes paraprake dhe ndertimi i rrjetit te siperfaqeve prove
- Mjetet per punen e terrenit

Puna ne terren duhet te kryhet duke perdorur mjete elektronike si: GPS dhe tablete per grumbullimin e informacionit ne siperfaqet prove.

- Planifikimi inventarizimit dhe pershkrimi i rrjetit te siperfaqeve prove
- Metoda e inventarizimit dhe kampionimi per matjet e kullotave
- Futja e te dhenave dhe kontrolli
- Pershkrimi parcelar
- Te dhenat parcelare dhe lidhja me Kadastrin Pyjor dhe SISP

PUNA NE ZYRE-RAPORTIMI

Proçesi per hartimin e Planit te Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave duhet te respektoje standartet ne menyre qe te perftohen produkte finale homogjene (raporti, te dhenat, hartat etj) me qellim perpunimin e te dhenave, transferimin e tyre ne SISP dhe nje koherence me IKP. Pjeset e shkruara te raportit, tabelat dhe hartat duhet te jene ne perputhje me udhezimet e dhena ne Udhezuesin 2019 per Planet e Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave. Sekuenca e permbajties duhet te ruhet. Parimi i shkrimit te raportit eshte: "shkruaj shkurt dhe thjesht".

Struktura e raportit jepet me poshte:

- Hyrje
- Gjendja e Ekonomise Pyjore ne te kaluaren
- Gjendja aktuale e Ekonomise pyjore
- Pershkrimi i kushteve stacionale
- Vegjetacioni dhe biodiversiteti
- Lista e parcelave pyjore ne Ekonomine Pyjore
- Pershkrimi i pyjeve dhe kullotave
- Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave
- Funksioni i pyjeve dhe kullotave
- Mbareshtimi i pyjeve - Mbareshtimi i Kullotave
- Masat dhe nderhyrjet
- Planifikimi vjetor i nderhyrjeve
- Vleresimi ekonomik i nderhyrjeve te planifikuara
- Transferimi i planit tek SISP

PERGATITJA E HARTAVE

Ato duhet te realizohen ne sistemin GIS.Hartat qe do te perгатiten jane:

1. Harta e Ekonomise Pyjore
2. Harta e Funksioneve
3. Harta e tipeve te pyjeve, shkurreve dhe kullotave
4. Harta e rrjetit rrugor, infrastruktures dhe siperfqeve te degraduara

5. Harta e nderhyrjeve

RAPORTET

- **Raporti Fillestar:** Eshte raporti fillestar i hartuar pas perfundimit te hapit te pare lidhur me prezantimin e tij tek te gjithë palet e interesit, vizitat e para ne terren, krijimin e grupeve te punes, percaktimin e metodologjise per punen e terrenit, pergatitjen e hartave baze dhe ndertimin e rrjetit te siperfaqeve prove. Ky raport duhet te dorezohet brenda 60 diteve nga firmosja e kontrates.

Raporti Dytë (Draft raporti planit mbarështimit) ky raport duhet të hartohet në perputhje me udhëzuesin në fuqi për hartimin e PMPK. Ky raport në këtë fazë të punës përmbledh të gjithë të dhënat e marra e grumbulluar nga matjet direkte në terren dhe përshkrimin e elementeve teknike të n/ngastrave të kësaj ekonomie pyjore (duhet të paraqitet brenda afateve kohore të shprehura ne planin e punës së paraqitur).

Raporti përfundimtar paraqitet pas miratimit te PMPK, bazuar ne aktet ligjore në fuqi.

6. Detyrat që ndiqen për hartimin e planit të mbarështimit

Detyrat që duhet të zbatojë subjekti i kontraktuar me qëllim hartimin e planit të mbarështimit të pyjeve janë:

- Grumbullimi dhe shqyrtimi i literaturës për të vlerësuar gjendjen aktuale të burimeve pyjore/kullosore në ekonominë pyjore;
- Përshkrimi i përgjithshëm në terren i ngastrave e n/ngastrave, verifikimi i kufijve, përcaktimi definitiv në terren duke shënjuar me bojë vaji kufijtë e tyre, hedhja e ndryshimeve në hartë dhe llogaritja e sipërfaqeve përkatëse; gjate punes (ne terren apo ne zyre) të mbahet parasysh se nuk duhet ndëruar numri dhe madhesia e parcelave nga ai aktuale, mund te kete shtese apo paksim te nenparelave sipas rastit por brenda konturit aktual te parceles.
- Vlerësimi i sipërfaqes dhe volumit të pyjeve sipas formave të ndryshme të qeverisjes:

- Trungishte

- Cungishte

- Shkurre

-
- Vlerësimi kullotave/livadhe, përfshirë kapacitetin prodhues të tyre si dhe atë mbajtës;
 - Vlerësimin e llojshmërisë dhe sasisë së prodhimeve jo-pyjore (prodhimeve të dyta);
 - Identifikimi i problematikës lidhur me aspektet menaxhuese të pyjeve;
 - Identifikimi i çështjeve kyçe që kanë të bëjnë me aspektet ligjore, administrative dhe ato të menaxhimit, faktorët dhe aktorët që influencojnë;
 - Identifikimi i zgjidhjeve sociale bazuar në potencialet ekologjike të zonës;
 - Eksplorimi dhe propozimi i alternativave më të mira të menaxhimit të bazuara dhe të integruara në nevojat e ruajtjes dhe zhvillimit të fondit pyjor dhe të komunitetit të zonës;
 - Hartografimi i territorit të zonës duke përfshirë:
 - Ekonominë pyjore, ndarjen e ngastrave e të n/ngastrave, llojet pyjore dhe format e qeverisjes;
 - Përdorimin e territorit të zonës;
 - Masat e propozuara të parashikuara për përmirësimin dhe trajtimin e pyjeve;
 - Rrjetin e përhershëm dhe të përkohshëm të sipërfaqeve provë;
 - Ngritjen e një sistemi të përhershëm dhe përkohshëm sipërfaqesh provë për matjen (dhe më tej monitorimin periodik) dhe llogaritjen e volumit të pyjeve, bazuar në udhëzuesin përkatës të hartimit të planit të mbarështimit;
 - Marrja e profileve të tokës për çdo tip toke dhe kategori thellësi;
 - Zhvillimi i një vizioni, misioni dhe objektivi kryesor të menaxhimit për ekonominë pyjore;
 - Propozimi i strategjive të duhura të menaxhimit, si dhe planit të veprimit;
 - Plani i monitorimit të menaxhimit dhe aktiviteteve që priten të zhvillohen në zonë;
 - Hedhja e të dhënave të grumbulluara në terren dhe përpunimi kompjuterik i tyre;
 - Diskutimi dhe konsultimi i aktiviteteve kryesore të planifikimit dhe zbatimit të planit të menaxhimit me palët e interesuara;

-
- Konsultimi i draft-planit të menaxhimit me aktorët vendimarrës (Bashkia Vau Dejës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësitë Administrative, banorët, shoqatat , perdoruesit etj).
 - Ripunim materiali pas vërejtjeve të bëra.

Objektivat e përgjithshme dhe specifike të planit të mbarështimit

Objektivi i përgjithshëm i planit të mbarështimit duhet të jetë menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore/kullosore në pronësi të Bashkisë Shkoder (edhe nga këndvështrimi ekologjik), me strukturë dhe cilësi të mirë në përshtatje me kushtet e zonës dhe në përputhje me objektivat e mbarështimit.

Objektivat specifike të planit të mbarështimit do të jenë:

- Përcaktimi i përdorimit të territorit në përputhje me gjendjen lokale dhe nevojat;
- Optimizimi i formës së qeverisjes në përputhje me nevojat lokale, mundësitë e grumbullit pyjor dhe mjedisit për të përmirësuar prodhimtarinë;
- Optimizimi i funksioneve ndërmjet nevojave dhe mundësive ekologjike/silvikulturale në përputhje me rëndësinë multifunksionale, sociale dhe mjedisore të pyjeve;
- Përmirësimi dhe mirëmbajtja në një gjendje të mirë funksionale të grumbujve pyjor;
- Rritja e prodhimtarisë së pyjeve me funksion prodhues;
- Përmirësimi i cilësisë dhe gjendjes së grumbujve të trungishteve me funksion prodhues;
- Nxitja dhe përdorimi i ripërtëritjes natyrore sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim që të krijohen ekosisteme pyjore që i përshtaten mjedisit;
- Pakësimi i impakteve negative në gjendjen fitosanitare të pyjeve, dhe prerjeve të paligjshme;
- Rehabilitimi dhe garantimi i rritjes së qëndrueshme të prodhimtarisë në sipërfaqet pyjore/kullosore;
- Sigurimi i pjesëmarrjes së gjërë të popullsisë lokale në marjen e vendimit për menaxhimin e pyjeve/kullotave;

-
- Përmirësimi i menaxhimit të pyjeve duke lidhur resurset pyjore/kullosore me interesat e përdoruesve.

7. Përmbajtja e Planit të mbarështimit të Ekonomisë Pyjore do të përbëhet nga dhe jo vetëm:

1. HYRJE
2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË
3. GJENDJA AKTUALE E PYLLIT
4. VLERËSIMI I MBARËSHTIMIT TË MËPARSHËM
5. OBJEKTIVAT E MBARËSHTIMIT
6. MASAT PËR MBARËSHTIMIN E PYLLIT
7. GJENDJA DHE MASAT PËR INFRASTRUKTURËN
8. PLANIFIKIMI EKONOMIK
9. INDIKATORËT PËR MONITORIM DHE VLERËSIM
10. UDHËZIME PËR REVIZIONIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT
11. PLANI 10 VJEÇAR I PUNIMEVE TË PROPOZUARA SIPAS KATEGORIVE TË PUNIMEVE

PJESA E DYTË (Përshkrim parcelar) Lista e ngastrave, n/ngastrave me të dhënat kryesore.

PJESA E TRETË INVENTARIZIMI Rezultatet e sipërfaqeve prove etj

PJESA E KATËRT Harta e gjendjes ekzistuese (përdorimi i territorit)

Harta e punimeve të propozuara

Harta e përhapjes së llojeve drusore

Harta e ekonomisë pyjore sipas nën/ngastrave (Ortofoto)

Harta e shtrirjes së sipërfaqeve prove të përhershme dhe të përkohshme etj

Inventarizimi i grumbujve dhe metoda e punës për hartimin e planit të mbarështimit do të bazohet në Inventarizimi i grumbujve dhe metoda e punës për hartimin e Planit të Mbarështimit do të bazohet në Manualin e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019.

Plani i mbarështimit i hartuar nga kontraktori së bashku me hartat pyjore dhe dokumentacioni shoqërues do të dorëzohen pranë autoritetit kontraktor në 4 kopje të printuara dhe 4 kopje në format elektronik (CD).

- STAFI DHE EKSPERIENCA.

Subjekti i kontraktuar duhet të jetë i pajisur me licencë të kategorisë III.7.A, sipas shtojcës së ligjit përlicencat dhe duhet të ketë në përbërje staf pune të kualifikuar për hartimin e Planit të Mbarështimit, me eksperiencë minimale 10 vjet në fushat respektive të ekspertizës.

Kontraktori/ Konsulenti duhet të ketë në strukturën e skuadrës së tij, ekspertët kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomik-administrativ.

Stafi kryesor i kontraktorit duhet të ketë në përbërje minimalisht specialistë të profileve si më poshtë:

- a) Te pakten 1 (nje) Inxhinier Pyjesh i cili do te jete dhe Drejtues Teknik, certifikuar si ekspert pyjesh dhe kullotash,
- b) Te pakten 2 (Dy) Inxhiniera Pyjesh, te certifikuar si eksperte pyjesh dhe kullotash.
- c) Te pakten 2 (Dy) teknike Pyjesh, me eksperience, verifikuar me dokumentacionin perkates.
- d) Te pakten 1 (nje) Inxhinier Gjeodet / Gjeoinformatike,

Eksperienca e punës dhe profilet e specialistëve të stafit/ ekspertëve kryesorë do të duhet të vërtetohen nga ana e kontraktorit me kontratat individuale të punës (e vlefshme gjatë kohës së hartimit të planit), kopje të librezave të punës, dhe kopje të diplomave.

Eksperienca e punës dhe profilet e specialistëve të stafit mbështetës do të duhet të vërtetohen nga ana e kontraktorit nëpërmjet CV-së.

Kualifikimi i përgjithshëm i stafit përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencë

Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

- MONITORIMI I FAZAVE TË HARTIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT.

Autoriteti kontraktor do të monitorojë fazat e ndryshme të hartimit të Planit të Mbarështimit dhe punimet që realizohen nga subjekti kontraktor nëpërmjet grupit të monitorimit që do të ngihet me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor.

Grupi i monitorimit do të ketë në përbërje 3 specialistë të pyjeve (inxhinier pyjesh) nga strukturat përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave pranë Bashkisë , të cilët do të monitorojnë procesin e hartimit të Planit të Mbarështimit nga subjekti i kontraktuar

- MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT.

Në zbatim të parashikimeve të ligjit nr 57/2020 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, kreu i tretë, neni 11, pika 2.b dhe 3.a; Projekti i Planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore të hartuar nga kontraktori, pasi ti nënshkrohet konsultimit me aktorët e fushës (Nj.administrative. shoqatat e pyjeve, komunitetin) dhe të miratohet në këshillin bashkiak, do të dërgohet zyrtarisht për konfirmim përfundimtarë, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Shënim: Punimet e terrenit do të kryhen gjatë periudhës së vegjetacionit.

Afatet e shërbimit: Për realizimin e hartimit të Planit të Mbarështimit për këtë ekonomi pyjore parashikohet një afat kohor 9 muaj sipas grafikut të ekzekutimit.

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit

kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet te shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të tre viteve të fundit financiare (2022, 2023,2024), lëshuar nga Administrata Tatimore. *Vlera minimale e xhiros vjetore duhet të jetë jo më e vogël se 12 616 500 lekë.* Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për **furnizimet e mëparshme, të ngjashme**, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte nje vlerë **jo më e vogël se 20%** të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates. Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje nga dokumentat e meposhtem:

